

## STATUTI I SHOQERISE

### “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k

#### NENI 1

##### Emertimi dhe Forma e Shoqërisë

1.1 “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k themelohet në formën e nje shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i kesaj shoqërie do të rregullohet nga ky Statut dhe nga ligji nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

1.2. Emërtimi “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

1.3. Shoqëria “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

#### NENI 2

##### Dokumentat Rregullues

2.1. Dokumenti kryesor mbi të cilin bazohet aktiviteti i Shoqërisë “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k është Statuti i saj. Me anë të këtij Statuti dhe në përputhje me Aktin e Themelimit dhe me legjislacionin shqiptar, rregullohet pozita juridike e Ortakëve dhe punonjësve të Shoqërisë, organizimi dhe objekti i veprimtarisë së Shoqërisë dhe çështjet e tjera me rëndësi për aktivitetin e saj.

2.2 Per çështjet që nuk zgjidhen nga Statuti, Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një Rregullore të Veçantë.

2.3. Statuti dhe Rregullorja e Veçantë janë dokumenta të hapura për ndryshime dhe përmirësime që zhvillimet i bëjnë të nevojshme.

#### NENI 3

##### Ortaku

2.1 Ortak i “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k është:

- Znj.Elda IBRO person me shtetësi shqiptare, e datelindjes 03.08.1981, lindur në Tepelene dhe banuese në adresën Rruga “Margarita Tutulani” Pallati 8 Ap.32, Tirane, Shqipëri, Mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 036362311

#### NENI 4

##### Selia

4.1. Shoqëria “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k e ka selinë e saj në adresën: Rrugen Reshit Petrela, Tirane.

4.2. Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensite të saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe do të veprojnë nën mbikqyrjen e Administratorit të “MICRO CREDIT ALBANIA” Sh.p.k.

## **NENI 5**

### **Vula, Stema**

5.1. Shoqëria "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k ka vulen e saj mbi te cilen ka te shkruar emertimin e saj.

5.2. Stema e "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k duhet te figuroje ne te gjithë materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare te Shoqërisë.

## **NENI 6**

### **Kohezgjatja**

6.1. Shoqëria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

## **NENI 7**

### **Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë**

7.1. Shoqëria "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.P.K ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

7.2. Veprimtaria e Shoqërisë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k, do të ketë për objekt:

Ushtrimin e veprimtarisë së kredidhenies ne te gjitha format e saj dhe veprimtarine per te ofruar sherbimet keshilluese, ndermjetese dhe sherbime te tjera ndihmese per veprimtarine e kredidhenies si subjekt financiar jobanke sipas legjislacionit dhe rregulloreve te 2 Bankes se Shqiperise si Institucionit Financiar Kredidhenes . Shoqëria mund te lidhe, menaxhoje ose negocioje cdo marrveshje tjeter lidhur me garantimin e kredive ose mund te kryeje cdo lloj veprimtarie tjeter qe eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe qe siguron fitime dhe te ardhura te ligjshme brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Shoqëria, me vendim te administratorit, dhe pas miratimit paraprak te asamblese se pergjithshme, mund te lidhe marreveshje tregtare apo bashkepunimi me shoqeri apo sipermarrje te tjera, si dhe te kryeje cdo veprim tregtar qe konsiderohet i nevojshem me qellim arritjen e objektit te veprimtarise se saj.

## **NENI 8**

### **Kapitali i Shoqërisë**

8.1. Kapitali themeltar i shoqërisë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k eshte 102 000 000 (njqind e dy milion) Leke, dhe eshte depozituar ne nje llogari bankare te vecante sipas percaktimeve ligjore.

Kapitali perbchet nga 1 (nje) kuote.

Vlera e një kuote në Shoqërinë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k është 102 000 000 (njqind e dy milion) Lekë.

Ky kapital është formuar nga themeluesja e shoqërisë si më poshtë:

**znj. Elda Ibro** me 102 000 000 (njqind e dy milion) lekë duke zotëruar 100 % të kuotave ose 1 (nje) kuote.

## **NENI 9**

### **Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k. janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratori.

## **NENI 10**

### **Asambleja e Pergjithshme**

10.1. Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime për çeshtjet që ligji apo ky statut ia rezervon këtij organi, si dhe për çeshtjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Pergjithshme.

10.2. Vendimet e Asamblesë së Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjister të posaçëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k.

10.3. Përveç rasteve të miratimit të llogarive vjetore si dhe ndryshimeve të Statutit, Asambleja mund të marrë vendime edhe me anë të konsultimit me shkrim të ortakeve. Administratori ka të drejtën e zgjedhjes së formës së marrjes së vendimit ndërmjet mbledhjes së Asamblesë ose konsultimit me shkrim.

## **NENI 11**

### **Marrja e vendimeve**

11.1. Çdo ortak, pavarësisht nga numri i pjesëve të kapitalit që zotëron, ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe në vendimet e asamblese dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron.

11.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet në këto mbledhje nga një ortak tjetër ose nga një mandatmbajtës i cili mund të votojë në emër të atij që përfaqëson. Mandati i përfaqësimit nuk mund të jetë i përhershëm, por jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë. Mandati i dhënë për një mbledhje të Asamblesë është i vlefshëm për mbledhjet e tjera, që thirren si vazhdim i së parës dhe me të njëjtin rend dite.

## **Neni 12**

### **Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve**

12.1. Janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- a. ndryshimit të Statutit;
- b. riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi;
- c. linjat baze për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë;
- d. zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjesëve të kapitalit themeltar nga vete shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- e. miratimi i llogarive, raportit vjetor, inventaret, raporti i eksperteve kontabel të autorizuar;
- f. hapja e filialeve, degeve apo zyrave të reja;
- g. marrja hua, lenia peng apo çdo barrë tjetër siguruese;
- h. hapja e një aktiviteti të ri ekonomik;
- i. emerimi dhe shkarkimi i Kryetarit të Asamblese;
- j. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- k. emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel të autorizuar;
- l. blerja e pasurive të paluajtshme;

m. blerja e aksioneve, certifikatave apo titujve te shoqerive te tjera tregtare, apo e çdo lloj instrumenti financiar;

n. Prishjen e shoqerise ne rast se humbjet jane me te medha se 20 % e kapitalit;

o. Shnderimin e Shoqerise në një formë tjetër;

p. vendos per vendet e punes, detyrat dhe shperblimet perkatese;

q. si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asamblese.

### **NENI 13**

#### **Administratori i Shoqërisë**

13.1. Shoqeria administrohet nga Administratori, nje person fizik qe mund te jete ose jo ortak i Shoqerise.

13.2. Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqërinë "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k në përputhje me ligjin « Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare », këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

### **NENI 14**

#### **Emërimi dhe shkarkimi i Administratorit**

14.1. Administratori i Shoqerise emrohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 3(tre) vjetesh.

14.2. Administratori i shoqerise eshte z.Andis Gjoka

14.3. Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

### **NENI 15**

#### **Kompetencat e Administratorit**

15.1. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne emer dhe per interes te Shoqerise "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe/ose ky Statut i japin shprehimisht Asamblese së Pergjithshme. Ndryshimi i kompetencave te Administratorit vendoset me unanimitet nga Asambleja e Pergjithshme.

15.2. Administratori ka te drejte te perfaqesoje Shoqerine para te treteve dhe te gjitha vendimet manaxheriale te Shoqerise "MICRO CREDIT ALBANIA" Sh.p.k duhet te nenshkruhen te pakten nga Administratori.

15.3. Asambleja e Ortakëve mund t'i japë autorizim paraprak Administratorit për kryerjen e operacioneve të caktuara ose lidhjen e kontratave të cilat konsiderohen tepër të rëndësishme për Shoqërinë.

### **NENI 16**

#### **Mosmarreveshjet**

16.1. Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompentent do te jete Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane.

16.2. Ky Statut redaktohet ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet me vullnetin e tij te lire nga ortakët themelues.

### **ORTAKET THEMELUES**

**ELDA IBRO**

